




REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT

MUNICIPALITY OF DEÇANI - OPSTINA DEÇANI



Drejtoria për Arsim në Deçan

07 Nr.

Deçan , dt.21.10 .2016

Në bazë të kërkesave të shkollave t, konform dispozitave të nenit 8 pika 1 dhe 2 të Ligjit të punës Nr.03/L-212, , dispozitave ligjore të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës nr.04/L-032 , nenit 5 pika (c) të Ligjit nr.03/L-068 për Arsimin në komunat e Republikës së Kosovës si dhe mbështetur në dispozitat e Udhëzimit Administrativ MASHT nr.06/2015 për normativin mbi kuadrin profesional të Arsimit të Përgjithshëm, Drejtoria për Arsim në Deçan, shpall : :

KONKURS

Për plotësimin e vendeve të lira të punës në këto Institucione edukative Arsimore aftësuese në komunën e Deçanit

I. SH.F.M.U. “ Vëllezërit Frasheri “ në Deçan

1. Një mësimdhënës të lëndës së Artit Figurativ për 20 orë mësimi në javë.

II. SH.F.M.U. “ Isa Boletini “ – Isniq.

1. Një mësimdhënës të mësimi klasor, (zëvendësim i pushimit të lehonisë).

III. SH.F.M.U. “ Lidhja e Prizrenit “ në Deçan.

1. Një mësimdhënës të lëndës së Teknologjisë - Informatikë për 5 orë mësimi në javë dhe 5 orë në SH.F.M.U. “ Kuvendi i Verrave të Llukës “ në Llukë të Epërme (zëvendësim i pushimit të lehonisë).

IV. SH.F.M. U. “ Kuvendi i Verrave të Llukës “ në Llukë të Epërme.

1. Një mësimdhënës të mësimi klasor (zëvendësim i pushimit të lehonisë).

KUSHTET : Kandidatët e interesuar për konkurrim për të gjitha vendet e lira të punës duhet ti plotësojnë kushtet e parapara sipas Ligjit për Arsimin Parauniversitar , si dhe Udhëzimit Adnistrativ të MASHT-it ,nr.06/2015 të kenë kualifikimet përkatëse profesionale të kryera.

- Për pozitën : I-1 kërkohet :- Master , Fakulteti i Arteve të bukura Sistemi katërvjeçar, Bachelor katërvjeçar i Artit Figurativ.
- Për pozitën: II-1, dhe IV-1 kërkohet : Fakulteti i Edukimit – Programi Fillor.

- Për pozitën : III-1 kërkohet : Fakulteti i Edukimikt- Programi i mësimdhënies në Teknologji dhe TIK, FSHMN dega – Shkencat kompjuterike, FSHMN dega e Informatikës, Sistemi katërvjeçar, dhe Bachelor katërvjeçar.

Dokumentacionii i nevojshëm për konkurrim :

- Çertifikata e lindjes (apo kurorëzimi për femrat e martuara),
- Diploma e shkollës së kryer në origjinal apo e legalizuar dhe
- Vërtetimi për përvojën e punës në arsim.

Të drejtat dhe obligimet parashihen me kontratën e punës me rastin e punësimit..

Lista e ngushtë përpilohet me dt.02.11.2016 në Web faqe të komunës së Deçanit dhe në të njejtën ditë caktohet data e intervistimit të kandidatëve.

Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Drejtoratin për Arsim në Deçan.

Konkursi mbetet i hapur në afat kohor prej 8 ditësh nga dita e publikimit në mjetet e informimit publik ditor.

Drejtori,
Qazim Maloku

 HYRJE-MALOKU REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLICA KOSOVA - REPUBLIQUE DU KOSOVO KOMUNA DEÇAN - OPSTINA DEČAN - DEÇAN MUNICIPALITY	
Reg. Nr. <u>DKA-Deçan</u> Data <u>07</u>	Nr. Prot. <u>32505</u> Data <u>21-10-16</u>

